



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 703/2 Prot.

Durrës, më 5.04.2024

VENDIM

Nr. 32, datë 05.04.2024

PËR

"NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.31, DATË 5.4.2024 "PËR SHPALLJEN E ZGJEDHJEVE TË REJA PËR SEKRETAR TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, të Urdhrit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë", të vendimit të Senatit Akademik nr.29 datë 29.03.2024 për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", neni 6, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e pikës 3 dhe pikës 5 të Vendimit nr.31, datë 5.4.2024 "Për shpalljen e zgjedhjeve të reja për sekretar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës" si më poshtë:

Pika 3: "Kandidatët për sekretar të KIZ-it janë staf ndihmës akademik me karakter administrativ me kohë të plotë dhe vetëkandidohen".

Pika 5: "Pas përfundimit të afatit të përcaktuar për kandidim, sekretaria e Senatit Akademik pasi konfirmon të dhënat për stafin ndihmës akademik me karakter administrativ me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, përcjell listën e kandidaturave të regjistruara për votim në Senatit Akademik".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI

